



Prishtinë, 10 korrik 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1165\_2019

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 19, 20 dhe 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016;
- Vendimin V\_941\_2018 për shtyrje të vlefshmërisë së vendimit për autorizimin preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018 lëshuar shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin "Wind Park –SELAC 2" me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës; dhe
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018 për Modifikimin e Turbinave të Erës nga 10 turbina sa ishin të Autorizuara në 9 Turbina, dhe kapaciteti i instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës, të datës 03.06.2019 të shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., me adresë rruga "Mujo Ulqinaku" nr. 12 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 10 korrik 2019 nxori këtë:

## V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., dhe **MODIFIKOHET VENDIMI PËR AUTORIZIMIT FINAL V\_981\_2018** i datës 13 qershor 2018, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës Wind Park –SELAC 2, me të cilën modifikohet/reduktohet numri i turbinave nga 10 (dhjetë) turbina të erën në 9 (Nëntë) Turbina dhe kapaciteti i instaluar prej **34.47 MW**, ZK Kaqandollë dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, sipas Vendimit mbi plotësimin dhe ndryshimin e Lejes Ndërtimore Nr. K. III.02/2019 të datës 05.04.2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH).
- II. Obligohet** shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., pas përfundimit të punëve ndërtimore sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi, të aplikon për Certifikatë të Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent sipas Ligjit të Ndërtimit.
- III.** Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij vendimi, gjeneratori Wind Park –SELAC 2, do të hyn në Operim komercial sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse të



përcaktuar me vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organ kompetent.

- IV. Shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., obligohet që të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

### Arsyetim

- o ZRRE me datë 14.07.2013 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, në lokacionin "Wind Park – SELAC 2", komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga ERA, me datë 25 nëntor 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësojë kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o ZRRE me datë 06.11.2017 ka pranuar nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- o ZRRE me datë 29 mars 2018 ka lëshuar vendimin nr. V\_941\_2018 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_866\_2016 të datës 25 nëntor 2016, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 25 maj 2018.
- o ZRRE me datë 25.05.2018 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin "Wind Park – SELAC 2", me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW komuna e Mitrovicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga MMPH dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- o ZRRE me datë 13 qershor 2018 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_981\_2018 shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës në Lokacionin "Wind Park –SELAC 2" me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE me datë 03 qershor 2019 nga shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për Modifikimin e Turbinave të Erës nga 10 turbina sa ishin të Autorizuara në 9 Turbina, dhe kapaciteti i instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandoll dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës.
- o ZRRE s' bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final ka pranuar edhe Vendimin Nr. K.III-02/2019 të datës 05.04.2019 për plotësimin dhe ndryshimin e Lejes Ndërtimore Nr. ZSP-432/2018 numri i vrojtimit K.III-09/2018 të datës 23.05.2018 të lëshuar nga MMPH.



- Shoqëria "SOWI KOSOVO" L.L.C., në kërkesën e saj ka sqaruar se: sipas vlerësimit profesional të prodhuesit të turbinave është rekomanduar të bëhet reduktimi i numrit të turbinave nga 10 turbina sa kanë qenë me projektin fillestar në 9 turbinave, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit dhe rezultateve të gjenerimit të energjisë elektrike.
- Gjithashtu ka sqaruar se bazuar në monitorimin dhe vlerësimin e shpejtësisë së erës në lokacionin në fjalë, prodhuesi i turbinave ka sugjeruar mundësitë e optimizimit të gjenerimit të energjisë elektrike nga Era në Wind Park-SELAC 2, përmes turbinave të llojit tjetër dhe të reduktimit të numrit të tyre.
- Poashtu përveç rezultateve pozitive të, përzgjedhja llojit tjetër të turbinave do të reflektoj edhe në kostot financiare të projektit dhe rrjedhimisht, do të lehtësoj edhe realizimin e tij.
- Andaj, bazuar në këtë që tha më lartë dhe dokumentet e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që të aprovon modifikimin e autorizimit final pasi që kapaciteti instalues është 34.47 MW dhe numri i turbinave në Wind Park – SELAC 2 do të zvogëlohet.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa për modifikim është e bazuar, dhe dëshmitë e bashkangjitura janë bazë e mjaftueshme për të lejuar modifikimin e autorizimit Final V\_981\_2018 të datës 13 qershor 2018, dhe ndryshimin e numrit të turbinave nga 10 (dhjetë) turbina sa ishin të autorizuar në 9 (nëntë) turbina, dhe kapacitetit i instaluar prej 34.47 MW ZK Kaqandolë dhe Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Vendimi iu dërgohet:**


- Palës,
- Komunës së Mitrovicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i Rregullatorit:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfi, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar